



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-034

Prishtinë, më 27 shtator 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 27 SHTATOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryesuesit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 shtator 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 shtator 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 shtator 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të enjten, më 6 tetor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e adresave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës,
8. Shqyrtimi i Projekt-planit hapësinor 2010-2020 -Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re",
9. Shqyrtimi i Propozim-Strategjisë dhe Planit të veprimit për biodiversitetin 2011-2020,
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
12. Shqyrtimi i Propozimit i Avokati të Popullit për zgjedhjen e zëvendësve të tij,
13. Njoftimi i deputetëve nga radha e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Goran për ndarjen e mandateve për përfaqësim e tyre në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Po ashtu, Kryesia konstatoi se këtij rendi të ditës mund t'i shtohen edhe pika të tjera, që mund të përgatiten ndërkohë, të cilat duhet të konfirmohen në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:35** minuta.

Nënkryetari i Kuvendit,

Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.